



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**UDHËZIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.9.2018 “PËR  
VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË  
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 29, datë 10.9.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “b” e pikës 3, të kreut I ndryshon si më poshtë:

*“b) Kontribut në kërkimin shkencor dhe/ose veprimtarinë krijuese;”*

2. Nën-pika “iii” e shkronjës “a” të pikës 4, e kreut I, shfuqizohet.

3. Shkronja “b” e pikës 4 e kreut I, ndryshon si më poshtë:

*“b) Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor, si vijon:*

*i. Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale, përfshirë edhe ato në fushën e mjekësisë për të gjitha ciklet e studimit.*

*ii. Konsultime/këshillim studentësh.*

*iii. Udhëheqje diplome të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë (“Master ekzekutiv” dhe Specializime afatgjatë);*

*iv. Kontroll i dijeve (provime, kolokuiume);*

*v. Përgatitje individuale;*

*vi. Ekspozitë, garë dhe shfaqje;*

vii. *Pjesëmarrja në komisione dhe/ose juri.*”

4. Shkronja “c” e pikës 4 e kreut I, ndryshon si më poshtë:

“c) *Kontributi në kërkimin shkencor dhe/ose veprimtarinë krijuese, përfshin si më poshtë:*

- i. *Pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare, konferenca, seminare, kongrese, workshop-e, krijimtari artistike në salla të indeksuara etj;*
- ii. *Publikime monografi, punime shkencore të botuar në periodikë apo serial botimesh shkencore ose artikuj të botuar në revista ndërkombëtare dhe/ose kombëtare me Bord Editorial dhe/ose veprimtari krijuese;*
- iii. *Pjesëmarrje në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore të IAL-së;*
- iv. *Udhëheqje në programe doktorale apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit;*
- v. *Përgatitja e projekteve të kërkimit shkencor dhe/ose veprimtarisë krijuese/artistike për aplikim në kuadër të thirrjeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.*

5. Shkronjat “d”, “f”, “h”, “j” dhe “k”, të pikës 4 të kreut I, shfuqizohen.

6. Shkronja “e” e pikës 4, e kreut I, ndryshon si më poshtë:

“e) *Kontributi institucional përfshin veprimtaritë akademike dhe administrative në mbështetje të njësisë bazë, njësisë kryesore, institucionit dhe administratës publike, si vijon:*

- i. *Hartimi i programeve të studimit;*
- ii. *Hartim i rregulloreve, evidencave, apo dokumentacionit të veprimtarisë administrative;*
- iii. *Përgatitje botimesh në IAL;*
- iv. *Pjesëmarrje në komisionet ad hoc të ngritura nga IAL;*
- v. *Pjesëmarrje në veprimtarinë e organeve të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe IAL-së.*
- vi. *Pjesëmarrje në grupe pune të ngritura nga institucione të administratës publike.”.*

7. Shkronja “g” e pikës 4, e kreut I, ndryshon si më poshtë:

“g) *Kontributi profesional përfshin si vijon:*

- i. *Veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie, inovacion dhe/ose shërbime të tjera të lidhura me të;*
- ii. *Ekspertizë;*
- iii. *Përhapje të njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të mësimdhënies;*
- iv. *Angazhim si krijues artistik në lidhje me përfshirjen e studentëve.*
- v. *Trajnim për transferime të teknologjisë, të shkencës dhe inovacionit në mësimdhënie;*

- vi. Hartim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare, pa përfshirë projektet e kërkimit shkencor dhe/ose veprimtarisë krijuese/artistike të cituar në shkronjën "e" të pikës 5 të këtij udhëzimi.
- vii. Angazhim si ekspert në grupe pune, të ngritura me urdhër ministri apo Kryeministri, si dhe në nivel rajonal nga bashkitë dhe qarqet."

8. Kreut II i udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"1. Ngarkesa mësimore vjetore në auditor, e llogaritur në orë mësimore, për personelin akademik me kohë të plotë, brenda IAL, është:

- a) Kategoria profesor - 180 orë mësimore
- b) Kategoria lektor - 200 orë mësimore
- c) Kategoria asistent lektor - 210 orë mësimore.

Orët faktike të veprimtarive në auditor, njehsohen në orë mësimore, sipas koeficienteve të mëposhtëm:

- a) 1 orë leksion - 1.25 orë mësimore
- b) 1 orë seminar - 1.0 orë mësimore
- c) 1 orë në laborator - 1.0 orë mësimore".

Çdo orë faktike e realizuar në auditor, mbi ngarkesën mësimore vjetore të mësipërme, është orë suplementare në auditor, e cila përlllogaritet sipas koeficientëve të njehsimit në orë mësimore dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 100 orë mësimore të pagueshme, brenda një viti akademik.

Personeli akademik me kohë të plotë nëse kategorizohet me orientim kërkimor, sipas procedurave të parashikuara nga IAL, të cilat evidentojnë output-in kërkimor të personelit akademik, mund të ketë ulje të detyrimit të ngarkesës mësimore në auditor deri në 35% të ngarkesës normale vjetore, sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të IAL-së. Orët suplementare në auditor për personelin akademik me orientim kërkimor nuk mund të jenë më shumë se 50 orë mësimore.

- 2. Personeli akademik me kohë të pjesshme, pavarësisht nëse i përket kategorisë profesor, lektor apo asistent-lektor, mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor deri në 150 orë mësimore. Personeli akademik me kohë të pjesshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor. Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të përfshihet edhe në veprimtari të tjera, të cilat sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi kanë kompensim financiar, por pagesa do të bëhet deri në ngarkesën mësimore maksimale të përcaktuar në auditor.
- 3. IAL-të mund të angazhojnë dhe personel akademik me kohë të pjesshme, të dedikuar në veprimtari të kërkimit shkencor, i cili nuk ka detyrim mësimdhënien, por që kontribuon në kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të pikës 5, të kreut I, të këtij udhëzimi.
- 4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, mund të përfshihet në grupet e punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve, të financuara nga programet e Bashkimit

*Evropian.*

*Për shkrimin e këtyre projekteve, grupit të punës i njihen deri në 350 orë të pagueshme, të cilat ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit të punës, të angazhuar për përgatitjen e projektit. Projekti duhet të përcaktojë si institucion menaxhues të tij, IAL-në, për të cilën grupi i punës po angazhohet. Grupi i punës miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe kryesore. Orët certifikohen nëse projekti ka konfirmim formal të dorëzimit dhe pas lëshimit të raportit përkatës të vlerësimit të projektit, pavarësisht nëse projekti rezulton apo nuk rezulton fitues.*

*Për personelin akademik me kohë të plotë, ngarkesa e pagueshme për përfshirjen në këto grupe pune, është deri në 100 orë mësimore/projekte në vit, të cilat paguhen si orë suplementare”.*

5. Për autoritetet drejtuese të IAL-ve publike, ngarkesa mësimore vjetore në auditor është:

- a) Rektor -65 orë mësimore.
- b) Zëvendësrektor -75 orë mësimore.
- c) Dekan -90 orë mësimore.
- d) Zëvendësdekan -115 orë mësimore.
- e) Përgjegjës departamenti -115 orë mësimore.”

6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë, si rregull, përmban deri në 3 (tre) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.

*Për nevoja të njësisë bazë të argumentuara, personeli akademik me kohë të plotë mund të ngarkohet edhe me lëndë të tjera, me kushtin që këto lëndë shtesë të jenë të njëjta apo të ngjashme me lëndët e ngarkesës normale, brenda ngarkesës së parashikuar në këtë udhëzim.*

7. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik me orientim kërkimor-shkencor, si rregull, përmban deri në 2 (dy) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë. Për nevoja të njësisë bazë të argumentuara, personeli akademik me orientim kërkimor-shkencor mund të ngarkohet edhe me lëndë të tjera, me kushtin që këto lëndë shtesë të jenë të njëjta apo të ngjashme me lëndët e ngarkesës normale, brenda ngarkesës së parashikuar në këtë udhëzim.

8. Për personelin akademik me kohë të plotë, në institut apo qendër të kërkimit e zhvillimit, mësimdhënia vjetore do të jetë 20% deri 30% e orëve mësimore, përkatësisht, sipas përcaktimeve të pikës I të kreut II, të këtij udhëzimi. Ky personel aktivizohet, si rregull, në fusha që përputhen me misionin e tyre. Për nevoja të veçanta të kërkimit, për këtë personel akademik mund të planifikohet mësimdhënie vjetore më e vogël së përcaktimi i mësipërm.

9. Doktorantët me kohë të plotë dhe që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës, mund të angazhohen në aktivitete mësimdhënëse mbështetëse jashtë auditorit, sipas përcaktimeve të nënpikave “i” dhe “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 4, të kreut I, si dhe në aktivitete kërkimore sipas përcaktimeve të pikës 5, të kreut I, të këtij udhëzimi. Angazhimi i doktorantëve në aktivitete të sipërcituara kryhet në kuadër të parashikimeve të programit përkatës të doktoratës, nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të doktoratës dhe sipas nevojave të njësisë bazë dhe asaj kryesore.

10. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik mund të reduktohet me propozim të njësisë bazë, aprovim nga njësia kryesore dhe me miratim nga bordi administrimit në rastin e përfitimit të një burse studimi jo më pak se 1-mujore, si dhe në raste të veçanta të angazhimeve në kuadër të kontributit institucional.
11. Një orë mësimdhënie në auditor zgjat 60 minuta.
12. IAL-ja përcakton në rregulloret e brendshme politikat e shpërblimit sipas funksioneve që kryhen nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe ai administrativ. Këto politika miratohen nga bordi administrimit të IAL-së.”
13. Elementet e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor, në IAL-të publike, njehsohen në orë mësimore, si vijon:
- a) Provime/mbrojtje teze diplome: - 0.4 / 0.5 orë për student.
- b) Kontrollë të pjesshme të programuara të dijeve: - 0.25 orë për student.
- c) Udhëheqje diplome cikli I/II/III:
- i. Cikli I/ “Bachelor” - 10 orë për diplomë
- ii. Cikli II/ “Master profesional” ose “Master i shkencave” - 20 orë për diplomë
- iii. Cikli III/ “Master ekzekutiv” ose Specializime Afatgjata - 30 orë /për diplomë
- ç) Udhëheqje doktrate: - 80 orë në vit.
- d) Mbikëqyrje e projekteve të kursit: - 1 orë për projekt.
- dh) Mbikëqyrje e detyrave të kursit: - 0.3 orë për detyrë.
- e) Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikave mësimore ngarkesa e përllogaritur si më poshtë:
- i. 1 ditë pune në praktikë është 5-orëshe; për praktikën në terren dhe praktikën mësimore profesionale, grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 20 studentë;
- ii. 1 orë ushtrime (mësime praktike) të moduleve/lëndëve sportive është 0.8 orë mësimore;
- iii. Për orët e ushtrimeve (mësime praktike) të moduleve/lëndëve në arte, grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 15 studentë;
- iv. Për orët e ushtrimeve (mësime praktike) të moduleve/lëndëve sportive, që zhvillohen në terren sportiv, palestër grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 18 studentë;
- v. Ndjekja e 1 orë praktike klinike në mjekësi është 0.5 orë mësimore;  
Praktikat mësimore/profesionale mjekësore, për të gjitha ciklet e studimeve, të cilat drejtohen nga mbikëqyrës klinikë, do të njehsohen 12 orë me 1 orë mësimore;
- vi. Ndjekja e 1 orë praktike spitalore në shkencë mjekësore teknike është 0.5 orë mësimore.
- ë) Përgatitje shfaqjeje, ekspozitë, koncerte, garë: 10–30 orë për shfaqje.
- f) Pjesëmarrje në komisione për mbrojtje diplome:
- Cikli I 5 orë për komision.
- Cikli II 10 orë për komision.
- Cikli III me përjashtim të doktoratës 15 orë për komision.

g) Oponencë teze doktorate:	25 orë për oponencë.
gj) Pjesëmarrje në juri doktorate:	
i. Kryetar	15 orë;
ii. Anëtar (jo oponent)	10 orë.
h) Pjesëmarrje në juri, të ngritura për fitimin e titujve akademik “Profesor i asociuar” dhe “profesor”:	
i. Kryetar	20 orë;
ii. Anëtar	15 orë.
i) Konsultime të programuara:	deri në 30 orë në vit.
j) Kolokuiume - 1 në semestër:	0.15 orë për student.

*Për anëtarët apo kryetarët e jashtëm të jurisë së doktoratës apo jurisë për fitimin e titujve akademik, masa e pagesës të përllogaritet për orë mësimi njësoj si për personelin akademik të brendshëm të IAL-së.*

14. *Personeli akademik, i cili angazhohet në veprimtaritë jashtë auditorit, të parashikuara në pikën 13, shkronjat “ç”, “g”, “gj” dhe “h”, paguhet për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare jashtë auditorit, të cilat nuk duhet të tejkalojnë kufirin maksimal prej 100 orësh të pagueshme brenda një viti akademik.*
15. *Orët suplementare të pagueshme për një anëtar të personelit akademik me kohë të plotë, duke përfshirë të gjitha parashikimet e këtij udhëzimi për orët suplementare në auditor, orët jashtë auditorit dhe orët për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, nuk mund të jenë më shumë se 300 orë të pagueshme brenda një viti akademik.*
16. *Në rastet e mos realizimit të ngarkesës mësimore të plotë, brenda 1 viti akademik, për arsye objektive si lejet e barrëlindjeve, dalja në pension pleqërie apo fillimi i marrëdhënieve të punës në mes të vitit akademik, llogaritja dhe ekzekutimi i pagesave të mbingarkesës mësimore të realizuar të kryhet sipas ngarkesës mësimore vjetore, të parashikuar për secilën kategori të personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1, të Kreut II të udhëzimit dhe jo sipas ngarkesës vjetore të reduktuar.”*
17. *Kreu III i udhëzimit ndryshon si më poshtë:*

*“1. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë. Të gjitha aktivitetet e veprimtarive që kryen personeli akademik në IAL, përfshihen në fondin e kohës vjetore të punës prej 1536 orë.*

*2. Planifikimi dhe evidentimi i angazhimit vjetor në secilën prej veprimtarive, të parashikuara në pikën 3 të Kreut I, të këtij udhëzimi, bëhet sipas normativave të mëposhtme:*

- a) Mësimdhënia (veprimtari në auditor dhe jashtë auditori): 50% - 70% të kohës vjetore të punës;*
- b) Kontributi në kërkimin shkencor: jo më pak se 20% të kohës vjetore të punës;*
- c) Kontributi institucional dhe profesional: deri në 30% të kohës vjetore të punës;*

*Në planifikimin e mësipërm përjashtohet personeli akademik me orientim kërkimor-shkencor.*

- 3. Çdo angazhim i personelit akademik në IAL, në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor të IAL-së, duhet të marrë përpara ushtrimin të veprimtarisë miratimin e bordit të administrimit të IAL-së.*
  - 4. Personeli akademik angazhohet në veprimtari mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, krijuese apo veprimtari të tjera, sipas profilit të kualifikimit të tij akademik dhe kontratës së punës të lidhur me IAL-në.*
  - 5. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë, ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës së përcaktuar në Kodin e Punës.*
  - 6. Evidentimi i ngarkesës vjetore, për të gjitha veprimtaritë ku është angazhuar personeli akademik, bëhet për çdo anëtar të personelit akademik të IAL-së. Elementet që duhet të përmbajë evidenca e ngarkesës vjetore, janë sipas modeleve bashkëngjitur këtij udhëzimi. Çdo IAL publike, në varësi me specifikat e IAL-së, miraton me vendim të senatit akademik evidencën e ngarkesës vjetore të personelit akademik. Evidenca duhet të jetë sipas përcaktimeve të buxhetit vjetor të IAL-së.*
  - 7. Me vendim të senatit akademik, çdo IAL publike miraton ngarkesën në orë për çdo aktivitet të veprimtarive të mësimdhënies, të cilat nuk janë njësuar në orë mësimore, sipas këtij udhëzimi, si dhe për çdo aktivitet të veprimtarive të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese, kontributit institucional dhe atij profesional.”.*
18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR**

**EVIS KUSHI**

UNIVERSITETI \_\_\_\_\_  
FAKULTETI I \_\_\_\_\_  
Departamenti i \_\_\_\_\_

Viti akademik \_\_\_\_\_

**EVIDENCE**  
**PËR PLOTËSIMIN E ORËVE NË AUDITOR**

Emri pedagogut:

XXXXXXXXXX XXXXXXXXXXXX

LËNDA:

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Semestri

Parë

DATA	PROGRAMI	KURSI	Numri studentëve	TEMA E MËSIMIT	Orë faktike			Orë mësimore gjithsej	Firma
					Lekcion	Seminar	Lab.		
XX.XX.2024		I/23..N	XX	Tema 1	1	0	0	1.25	
XX.XX.2024		I/23..N	XX	Tema 2	0	1	0	1	
XX.XX.2024		I/23..N	XX	Tema 3	0	0	1	1	
				Tema 4					
				Tema 5					
				Tema 6					
				Tema 7					
				Tema 8					
				Tema 9					
				Tema 10					
				Tema 11					
				Tema 12					
				Tema 13					
				Tema 14					
				Tema 15					
				Shuma	1	1	1	3.25	

Drejuesi i Departamentit

DEKANI / Zv. Dekani

Prof. Asoc. XXXXXXXX XXXXXXXXXXXX

Prof. Asoc. \_\_\_\_\_



Emri i pedagogut: **Prof. Dr. Emer MBIEMER**

Tabelë përmblledhëse: Realizimi ngarkesës në auditor për v.a. \_\_\_\_\_

Cikli	Lënda	Programi Studimit	Viti	Semestri	Kredite ECTS					Nr. Grupeve	Orë në auditor të parashikuara			Orë në auditor të realizuara faktike			Firma pedagogut			
					Leksione	Seminar/Ushtime	Laboratore	Orë veprimtari individu	Tot ECTS		Leksione	Seminar/Ushtime	Laboratore	Leksione	Ushtime	Laboratore		Leksione	Ushtime	Laboratore
Bachelor	Lënda 1		0	0	30.0	15.0	0.0	60.0	4.2	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 2		0	0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 3																			
	Lënda 4								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 5								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 6								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 7								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 8								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Përmblledhje Bachelor										0	0	0	0	0	0	0	0			
Master	Lënda 1		0	0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 2								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 3								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 4								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 5								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 6								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 7								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
	Lënda 8								0.0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Përmblledhje Master										0	0	0	0	0	0	0	0			
Totali										0	0	0	0	0	0	0	0			

Përmblledhëse veprimtarive mësimore në auditor

Veprimtaria në auditor	Orë në auditor të realizuara	Orë mësimore të konvertuara	Totali orë mësimore fakt	Norma (ngarkesa, sipas Udhëzimit)	Σ Orë mësimore suplementare
Leksione	1	1.25			
Seminare / Ushtime	1	1	3.25	180	-176.75
Laboratore	1	1			

Drejtnesi Departamentit

Prof. Asoc. Emer Albriemer, firmë

DEKANI / Zv. Dekani

Prof. Asoc. \_\_\_\_\_

UNIVERSITETI \_\_\_\_\_  
FAKULTETI I \_\_\_\_\_  
DEPARTAMENTI I XXXXXXXXXXXXXXXXX

Emri i pedagogut: Prof. Dr. Emer MBIEMER

Veprimtari Mësimore jashtë Auditorit (Orë suplementare të paguëshme)

Veprimtaria	Nr. Diplomave/ Ditë praktike	Koeficient	Orë suplementare	Σ suplementare
Udhëheqje diplomë G.K.H. II vit	0	0	0	0
Udhëheqje diplomë G.K.H. II vit	0	0	0	
Udhëheqje diplomë G.K.H. II vit	0	0	0	
Udhëheqje teze doktorate	0	0	0	
Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikave mësimore	0	0	0	
Oponentë teze doktorate	0	0	0	
Pjesëmarrje në juri doktorate	0	0	0	
Pjesëmarrje në juri, tituj akademik	0	0	0	

Drejuesi Departamentit  
Prof. Asoc. Emer MBIEMER, firme

DEKANI / Zv. Dekani  
Prof. Asoc.

UNIVERSITETI \_\_\_\_\_  
 FAKULTETI \_\_\_\_\_  
 DEPARTAMENTI \_\_\_\_\_

PEDAGOGU Prof.Dr. \_\_\_\_\_

**1. MËSIMDHËNIA**

**1.1 Mësimdhënia e normuar vjetore në auditor**

(Elementët e këtij seksioni meren nga tabela përmbledhëse e realizimit të ngarkesës në auditor)

Nr. Cikli i studimeve	Përshkrimi veprimtarisë	Koef. Konvertimit	Nr. Njësi	Shuma Orë
1	Leksione			
2	Ushtrime/Seminare			
3	Laboratorë			
4	Bachelor			
5	Leksione			
6	Ushtrime/Seminare			
7	Laboratorë			
	Master			
<b>Totali 1.1</b>				

**1.2 Elementet e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit të mësimdhënies**

Nr.	Përshkrimi i veprimtarisë	Koef. Konvertimit	Nr./njësi	Shuma/orë
1		Përshkrim koeficient		
1	Projekt kursi	1 orë/student		
2	Dejtrë kursi	0.3 orë/student		
3	Recensë diplome	Bachelor	5 orë/diplomë	
		Master	10 orë/diplomë	
		Cikli III-të	15 orë/diplomë	
4	Konsultime	30 orë/vit është max vjetor		
5	Këshillimi (pedagogu kujdestar)	20 orë/vit është max vjetor		
6	Kontrolle të programuara	0.25 orë/student		
7	Provime	0.4 orë/student		
8	Kolokium	0.15 orë/student		
9	Komision diplome	0.5 orë/student		
10	Përgatitja individuale	Bachelor (Lx2+Sx1)		
		Master Lx2.5+Sx1.5)		
		Bachelor (Lx2.5+Sx1.5)		
	As. Lektor	Master (Lx3+Sx2)		

11	Udhëheqje diplomash	Bachelor	10 orë/diplomë		
		Master	20 orë/diplomë		
12	Ndjekje/drejtim të praktikave profesionale		5 orë/ditë		
13	Oponencë doktoraturë		25 orë/doktoraturë		
14	Anëtar jurisë doktoraturë		10 orë/doktoraturë		
15	Kryetar jurisë doktoraturë		15 orë/doktoraturë		
			<b>Totali 1.2</b>		
			<b>Totali 1 (1.1+1.2)</b>		

<b>2. KONTRIBUTI NË KËRKIMIN SHKENCOR</b>					
Nr.	Përshkrimi i veprimtarisë	Ngarkesa orë/vit	Nr. Njësi	Shuma Orë	
1	Studim shkencor				sipas vendimit senatit
2	Hartim dhe aplikim i projektit kombëtar				sipas vendimit senatit
3	Hartimi dhe aplikim i projektit ndërkombëtar				sipas vendimit senatit
4	Konferencë kombëtare/ndërkombëtare				sipas vendimit senatit
5	Komiteti organizues/shkencor kombëtar				sipas vendimit senatit
6	Komiteti organizues/shkencor ndërkombëtar				sipas vendimit senatit
7	Relator artikulli shkencor (Revistë kombëtare/ndërkombëtare)				sipas vendimit senatit
8	Recenzues artikulli shkencor (Revistë kombëtare/ndërkombëtare)				sipas vendimit senatit
9	Seminar				sipas vendimit senatit
10	Workshop				sipas vendimit senatit
11	Kongres shkencor kombëtar/ndërkombëtar				sipas vendimit senatit
12	Monografia				sipas vendimit senatit
13	Oponencë monografi kombëtare/ndërkombëtare				sipas vendimit senatit
14	Artikull shkencor (botuar brenda/jashtë)				sipas vendimit senatit
15	Bord reviste shkencore				sipas vendimit senatit
16	Udhëheqje e doktoraturës				sipas vendimit senatit
				<b>Totali 2</b>	

<b>3. KONTRIBUTI INSTITUCIONAL</b>					
<b>3.1 Kontribut në kurrikula</b>					
Nr	Përshkrimi i veprimtarisë	Ngarkesa orë/program	Nr. Njësive	Orë gjithsej	
1	Rishikimi/Hartimi i programit të studimit të ciklit I				

2	Rishikimi/Hartimi i programit të studimit të ciklit II			
3	Rishikimi/Hartimi i programit të studimit të ciklit III			
4	Rishikimi/Hartimi i programit të studimit të formimit të vazhduar			
5	Rishikimi/Hartimi i programit të lëndës në ciklin I			
6	Rishikimi/Hartimi i programit të lëndës në ciklin II			
7	Rishikim/Hartim i programit të lëndës në ciklin III			
8	Rishikim/Hartimi i programit të lëndës në kurset e formimit të vazhduar			
<b>Totali 3.1</b>				

3.2 Kontribute të tjera				
Nr.	Pershkrimi i veprimtarisë	Ngarkesa orë/njësi	Nr. Njësi	Orë gjithsej
1	Hartimi i rregullores			
2	Hartimi i dokumentacionit të SBC			
	Përgatitja e botimeve univesitare			
3	Tekst mësimor			
4	Udhëzues laborator			
5	Udhëzues deyrash			
	Recensë e botimeve univesitare			
6	Tekst mësimor			
7	Udhëzues laborator			
8	Udhëzues deyrash			
9	Pjesëmarrje në komisionet ad-hoc			
10	Pjesëmarrje në veprimtaritë e departamentit			
11	Pjesëmarrje në veprimtaritë			
	Pjesëmarrje në veprimtaritë e institucionit(senat, bord, rektorat)			
13	Pjesëmarrje në komisione të përhershme			
14	Relator për tituj akademikë			
15	Pjesëtar i jurisë për tituj akademikë			
16	Pjesëmarrje në grupe të ngritura nga institucione të administratës publike			
<b>Totali 3.2</b>				
<b>Totali 3 (3.1+3.2)</b>				

4. KONTRIBUTI PROFESSIONAL			
Nr. Përshkrimi i veprimtarisë	Ngarkesa në orë	Nr. Njësive	Orë gjithsej
1 R&D			
2 Ekspertizë			
3 Përhapja e njohurive shkencore			
4 Trajnim për R&D, inovacion			
Totali 4			

PËRMBLEDHËSE VEPRIMTARIVE			
Nr. Përshkrimi i veprimtarive		Orë	%
1 Mësimdhënie dhe veprimtari mbështetëse			
2 Kontributi shkencor dhe profesional			
3 Kontributi institucional			
TOTALI ORËVE PËR VITIN AKADEMIK			

Pedagogu

Dr. \_\_\_\_\_

Zv dekan i për anën mësimore

Prof. \_\_\_\_\_

Drejtnes i departamentit

Prof. \_\_\_\_\_

Zv dekan i për anën shkencore

Prof. \_\_\_\_\_